INSTITUCIONET MUZEALE TË QYTETIT TË MITROVICËS

Botues: EC Ma Ndryshe
Shkurt, 2024

Institucionet Muzeale të qytetit të Mitrovicës

Analizë dhe dokumentim i gjendjes ekzsituese të institucioneve muzeale të qytetit të Mitrovicës

Autorë: Arta Januzi Cana
Blerta Breznica
Flaka Xërxa Beqiri
Marigona Rexha

Botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Institucionet Muzeale të qytetit të Mitrovicës" është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Zhvillimi i mëtejmë strategjik i organizatës me fokus në trashëgiminë kulturore gjithëpërfshirëse" përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe sportit.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

PËRMBAJTJA

Hyrje

1 Metodologjia dhe qëllimi i hulumtimit

2 Përkufizime mbi zhvillimin historik të institucionet muzeale, kategorizimet dhe karakteristikat funksionale

3 Muzetë në Kosovë

4 Institucionet muzeale të qytetit të Mitrovicës

- 4.1. Gjendja ekzistuese fizike
- 4.2. Operimi, kapacitetet njerëzore dhe shërbimet e ofruara
- 4.3. Analiza e hapësirave dhe sekuencat e lëvizjeve
- 4.4. Qasshmëria e personave me aftësi të kufizuara

Përfundime dhe rekomandime

Bibliografia

Lista e figurave

PËR EC

Shtojca 1: Dokumentimi dhe analiza e institucioneve muzeale të qytetit të Mitrovicës – Pjesa grafike

AKRONIMET

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
IAK – Instituti Arkeologjik i Kosovës
DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
PAK – Persona me Aftësi të Kufizuara

Hyrje

Një muze është një institucion jofitimprurës, në mënyrë konstante në shërbim të shoqërisë, që hulumton, mbledh, konservon, interpreton dhe ekspozon trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme. Duke qenë të hapur dhe gjithëpërfshirës për publikun, muzetë nxisin diversitetin e qëndrueshmërinë, duke ofruar përvoja të ndryshme për edukim, rekreim, reflektim dhe shkëmbim njohurish[1]. Ndër objektivat më të rëndësishlm të muzeut konsiderohen mbrotja e trashëgimisë kulturore, edukimi i përgjithshëm, insipirimi kreativ e të menduarit kritik, rrjedhimisht duke ofruar hapësirë për kërkim dhe zhvillim diskursesh. Përmes aktiviteteve të gjëra si, kolekcione të kuruara, ekspozita të përkohshme, programe të ndryshme edukuese, vizita të organizuara e të tjera, synohet përfshirja e vizitorëve dhe promovimi e njohjes së objekteve fizike dhe ideve të ekspozuara. Si i tillë, muzeu përbën një kategori ndërtesash arkitektonike të cilat nuk përbëjnë interes për shoqërinë vetëm si struktura fizike dhe kualitete estetike që ato përfaqësojnë, por edhe për institucionalizmin të cilin e bartin si epitet. Më konkretisht, muzetë cilësohen si institucione që kujdesen për koleksionim të artefakteve kulturore, historike dhe shkencore, të cilat i vënë në dispozicion të publikut dhe të cilat, varësisht nga kategorizimi i vet ekzpositës të cilës i takojnë, mund të jenë pjesë të ekspozitave të përhershme apo të përkohshme[2].

Të dhënat statistikore të publikuara lidhur me numrin e institucioneve muzeale në Kosovë konsiderohen të limituara, si për ato të nivelit qëndror ashtu edhe lokal[3]. Shumica e tyre i

[1] Definicioni i ri i muzeve, propozuar nga Këshilli Nërkombëtar i Muzeve (ICM – International Council of Museums), aprovuar në Konferencën e 26-të Gjenerale mbajtur në Pragë, më 24 Gusht 2022, qasur në Nëntor 2022, https://icom.museum/en/news/icom-approves-a-new-museum-definition/

[2] Alexander, E.P., Alexander, M., "Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums", Rowman & Littlefield, 2007

[3] EC Ma Ndryshe, "Prizreni 'qytet muze' pa muze?", Maj 2008, qasur në Nëntor 2022 https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530

takojnë kryesisht kategorisë së muzeve të historisë, arkeologjisë, etnologjisë dhe diciplinave të tjera të ngjashme.

Në mungesë të një strukture legjislative për muzetë, *Koncept Dokumenti për Art dhe Kulturë* i miratuar nga Qeveria e Kosovës, ndër të tjera përcakton, në cilësinë e objektivës strategjike nr.2, reformimin organizativ, funksional dhe konsolidimin e bredshëm të intitucioneve publike të kulturës dhe të muzeve. Ndër objektivat kryesorë të këtij dokumenti vlenë të theksohen:

(2.1) Krijimi e strukturave me përgjegjësi të përcaktuar qartë në promovimin kulturor, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e studimeve si dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe krijimtarisë kulturore;
(2.2) Sigurimi i qëndrueshmëriaë financiare dhe funksionale të institucioneve publike përmes decentralizimit të përgjegjësive për menaxhim financiar dhe administrativ të brendshëm;
(2.3.) Digjitalizimi dhe qasj në materiale dhe koleksione kulturore;
(2.4) Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e kulturës dhe krijimit te strukturave funksionale profesionale, teknike, administrative dhe logjistike[4].
Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 është një tjetër dokument i cili parasheh definimin e statutit të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe themelimin e institucioneve të reja, siç është Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnologjik dhe Muzeu i Historisë së Natyrës, krahas masave tjera të përfshira të cilat adresojnë përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore dhe realizimin e programeve trajnuese për ciceronë dhe kuratorë muzeal, menaxherë, laborantë dhe profesionistë të tjerë të lidhur me fushën e muzeologjisë.[5]

[4] MKRS – faqja zyrtare, "Miratohet Koncept-dokumenti për Art dhe Kulturë" qasur në Nëntor, 2022, https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,3041#.Y6bo1i-B2X0

[5] Jerliu, F., "Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017 – 2027", Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2016

Muzetë sot ndërkombëtarisht ballafaqohen me tendencën e evoluimit nga hapësirat e dedikuara kryesisht për ekspozim të eksponateve të artit, shkencës e historisë, në ato me edukim e ngritje joformale duke përfshirë biblioteka, galeri arti, hapësira për zhvillimin e projekteve të cilat trajtojne dhe pesë dimensione duke pasuruar kështu jetën shoqërore[6]. Duke qenë se në Kosovë mungesa e dokumentuar rreth gjendjes ekzistuese si dhe planifikimeve afatshkurëra dhe afatgjata të institucioneve muzeale është evidente, ky hulumtim synon analizoj dhe dokumentoj gjendjen ekzistuese të muzeve të qytetit të Mitrovicës, të cilit hulumtim i paraprinë ai i realizuar nga EC mbi institucionet muzeale të Prizrenit gjatë vitit 2022.

Hulumtimi paraprak ka trajtuar pesë muzetë kryesore të qytetit të Prizrenit, duke përfshirë: (1) Muzeun Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla, (2) Muzeun Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, (3) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (4) Muzeun e Kalasë së Prizrenit dhe (5) Muzen e Elektroekonomisë – Hidroeletrana "Prizrenasja", ku gjetjet kanë evidentuar të kenë nevoja substancionale lidhur me shërbimet e ofruara, organizimin dhe mënyrën e ekpozimeve të artefakteve.

Mitrovica në raport me Prizrenin, dallon edhe për nga përmbajtja dhe karakteri i institucioneve muzeale që gjenden në këtë qytet. Në Mitrovicë gjenden dhe veprojnë tre muze: Muzeu i Qytetit, Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA dhe Kompleksi i Kullave Isë Boletini (i cili zyrtarisht ende nuk është i regjistruar si muze, mirëpo operon si i tillë).

[6] Günay, B.,"Museum concept from past to present and importance of museums as centers of art education", International Conference on New Horizons in Education INTE2012, 2012

SHËNIM: Në këtë hulumtim është përfshirë studimi i hollësishëm i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve – TREPÇA si dhe Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit, ndërsa Muzeu i Mitrovicës është hulumtuar pjesërisht si rezultat i mos ofrimit të qasjes në informacion me rastin e adresimit të pyetjeve hulumtuese. Njëherit, në Muzeun e Mitrovicës EC ka patur qasje të limituar për faktin se disa nga hapësirat muzeale kanë rezultuar të jenë në renovim.


Fig. 1 Ilustrim i tri institucioneve muzeale të qytetit të Mitrovicës të përshira në hulumtim.



1. METODOLOGJIA E APLIKUAR DHE OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është identifikimi i problemeve aktuale dhe potencialeve që Institucionet muzeale të qytetit të Mitrovicës bartin sa i përket vlerave të trashëgimisë kulturore dhe shoqërore, rrjedhimisht dokumentimin e infrastrukturës së tyre fizike. Megjithë problemet politike e shoqërore që historikisht ky qytet i ka kaluar, Mitrovica bartë një bagazh të madh të trashëgimisë kulturore e industriale.

Përmes analizave operacionale, ky hulumtim vlerëson tërheqjen e vizitorëve si dhe potencialin e tyre për t'iu përgjigjur reformimeve të kohës drejt tendencave të institucioneve muzeale atraktive. Qasshmëria e personave me aftësi të kufizuara në këto institucione është gjithashtu pjesë vitale e analizave operacionale. Hulumtimi është i bazuar fillmisht në literaturë ekzistuse, të dhënave zyrtare nga organet kompetente, intervistave me zyrtar si dhe vrojtimit në teren të gjendjes ekzistuese.



2. ZHVILLMI HISTORIK I IINSTITUCIONEVE MUZEALE: KATEGORIZIMET DHE VEÇORITË FUNKSONALE

HISTORIKU

Në fillet e historisë së muzeve, fjala "muze" vlente për një *koleksion*, e jo për një ndërtesë siç do të mendohej. Vetëm nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë, kur u krijua ideja e muzeut dhe u ndërtua ndërtesa e parë e pavarur, me funksion të destinuar si muze, u krijua dhe një tipologji e re arkitekturore, ajo e ndërtesave muzeale, e cila mbeti deri në fillim të shekullit të njëzetë[7].

Fig. 2 Palazzo Medici, muzeu i parë në Evropë.



Sipas Kali Tzortzi, historia e muzeve nisë me Muzeun e Aleksandriës, themeluar nga Ptolemy Soter, në kohën kur Aleksandria ishte në fokus për zhvillimin e jetës intelektuale Helenistike, ndërkohë që në Renesansë, dallohet një kalim i ekspozimit të artefaktve muzeale nga hapësira e hapur në hapësirë private. Ndër muzetë e spikatur të kësaj periudhe, i cili bart edhe 'epitetin e muzeut të parë në Evropë' njihet Palazzo Medici në Firencë (1440)[8].

Fundi i Shekullit të XVII-të dhe fillimi i XVIII-të, sjell kalimin e trendeve muzeale nga hapësirat private në ato të destinimit publik, përkatësisht universitetet, akademitë, kishat dhe manastiret. Derisa në Shekullin XVIII-të,

[7] Tzortzi, K. "Museum Space – Where Architecture Meets Museology", Routledge, 2016, fq. 11-43

[8] Ibid.

sipas Tzorzit, koleksionet muzeale akomodohen në ndërtesë arkitektonike, Shekuli i XIX-të shënon themelimin e tipologjisë arkitektonike përmes ndërtimit të tri ndërtesave specifike muzeale, Muzeut Glyptotech në Munich (1816-30), Altes Museum në Berlin (1823 – 30) dhe muzeut Alte Pinakothek në Munich (1826 – 36)[9].

Muzetë e themeluara ne New York, si ai i Artit Modern në vintin 1929 dhe Muzeu i Guggenheimit (1959) janë tendencat e para moderne duke e tejkaluar diferencimin tipologjik. Më tutje në konteksitn e zhvillimit teorik, akirtekti modernist Ludwig Mies Van der Rohe, e shihte muzeun 'më tepër një hapësirë për kenaqësi artistike se sa një hapësirë për izolimin e veprave të artit'[10].

Fig. 3 Alte Pinakothek në Munich, b. Altes Museum në Berlin, c. Muzeu Glyptotech në Munich.



Fig. 4 Muzeu Guggenheim, New York.



[9] Tzortzi, K. "Museum Space – Where Architecture Meets Museology", Routledge, 2016, fq. 11-43

[10] Ibid.

TIPOLOGJITË E MUZEVE

Historikisht, bazuar në kumtesën e lexuar në takimin e Asociacionit të Muzeve në Newcastle – on – Tyne, në Londër (23 Korrik 1895)[11], institucionet muzeale mund të ndahen sipas llojit të koleksionit (Muzeu i Arteve, Muzeu i Historisë, i Antropologjisë, i Historisë së Natyrës, i Teknologjisë dhe Muzeu i Zhvillimit Ekonomik) dhe qëllimit në bazë të të cilit janë themeluar (Muzeu Kombëtar, Muzetë Lokal, të Qytetit apo Provincës, Muzeu i Shkollës apo Universitetit, Muzeu Profesional, ato të specializuara të një lëmie të caktuar të studimit, të zotuara nga individ apo shoqata).

Për më shumë, ndër tipologjitë tjera mund të listohen edhe: muzetë arkitekturore, muzetë arkeologjike, muzetë e artit, muzetë e automobilave, muzetë e dizajnit, muzetë e fëmijëve, muzetë etnologjike/etnografike, muzetë ushtarake dhe të luftës, muzetë e shkencës, muzetë virtuale etj.

Fig. 3 a.) Muzeu i Artit, Vienë, b.) Muzeu Arkelogjik, Izrael, c.) Muzeu i Historisë së Natyrës, Los Agelos







[11] Goode, G.B., "On the Classification of Museums", Vol. 3, No. 57 (Jan. 31, 1896), fq. 154-161

PËRMBAJTJET FUNKSIONALE TË HAPËSIRAVE

Në përgjithësi, hapësirat funksionale të të gjitha llojeve të muzeve karakterizohen me hollin hyrës, hapësirën pritëse dhe informuese, hapësirat ekspozuese të karakterit të përkohshëm dhe të përhershëm, deponinë e ruajtjes së koleksioneve, hapësirën e konzervimit dhe restaurimit si dhe njësitë administrative. Me qëllim të ruajtjes së sigurisë së eksponateve, është e rëndësishme një ndarje vitale e hapësirave në grupacione si vijon[12]:

- Hyrja, informatat, dyqan i suvenireve, kafene, toalete dhe garderoba
- Ekspozita e përhershme dhe e përkohshme
- Hapësirat për edukim, salla e ligjeratave dhe hapësirat për studim/hulumtim
- Zyret:administrative, kuratoriale, të konservizimit, të dizajnit etj.
- Punëtoritë për konzervim, laboratoret, paisjet e përpunimit të materialeve digjitale
- Depo e ruajtjes së koleksionit, hapësirat e sigurimit dhe inspektimit
- Mirëmbajtja e koleksionit të ekspozitës dhe punëtorive


Përcaktimi i tipologjisë së rrugëtimit të vizitorëve me qëllim frekuentimin e hapësirave ekpozuese dhe të gjitha hapësirave tjera përbërëse të cilat krijojnë një interaksion në tërësi është i rëndësishëm që në fillim të procesit të projektimit funksional të muzeve. Lidhur me këtë ekzistojnë disa tipologji të sekuencave të cilat vizitorët mund të ndjekin në një objekt muzeal: (a) i hapur, (b) qendror dhe me kthina anësore, (c) linear, (d) rrethor, (e) kompleks dhe (f) në formë labirinthi[13].

[12] Ed. Littlefield, D., "Metric Handbook – Planning and Design Data, Third Edition, Elsevier Ltd., 2008, fq.450 - 455

[13] Ibid.

Ekzistojnë disa modalitete të ekspozimit të koleksioneve në varësi të llojit të muzeut: duke variuar nga elementet e varura në mur apo sipërfaqe anësore (a, b, c), elementet të cilat qëndrojnë në mënyrë të pavarur (d, e), elementet e vendosura në korniza ekspozuese (f, g, h). Muzetë bashkëkohorë kanë integruar tashmë edhe modalitete të ekzpozimit multimedial[14].

Fig. 4 Tipologjia hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale në relacion me lëvizjen e publikut



Pavarësisht kategorizimit të muzeve, faktorët të cilët janë esencial në përcaktimin e kornizës funksionale të muzeve janë: kontrollimi i lagështisë, kontrollimi i pastërtisë së ajrit, ndriqimi dhe zërimi adekuat si dhe kontrollimi i sigurisë.

[14] Ed. Littlefield, D., "Metric Handbook – Planning and Design Data, Third Edition, Elsevier Ltd., 2008, fq.450 - 455

UDHËHEQJA DHE ADMINISTRIMI

Në botë aplikohen modele të ndryshme administrimit të muzeve dhe kjo për faktin Se një model i caktuar derivon nga diversiteti i koleksioneve të muzeve, por gjithashtu pasqyron një ambivalencë në të kuptuarit e rolit të muzeve në shoqëri, varësisht nëse muzetë janë ekspozues dhe interpretues të trashëgimisë kulturore, depozitorë të eksponateve me vlerë lidhur me historinë njerëzore dhe natyrore, instrumente për interaksion social në zhvillimin e një shoqërie apo vetëm hapësira për rekreim dhe kalim të kohës së lirë[15]. Ndërkombëtartisht menaxhimi i muzeve kryesisht bëhet nga niveli qendror, nga i cili buron edhe korniza ligjore e udhëheqjes së muzeve, të cilat përveç tjerash paraqesin pasuri shtetërore. Është një trupë e tërë udhëheqëse që në vete përmban specialist me njohuri për koleksionet, koleksionues, studiues, laborantë, dizajnerë, njohës të marrëdhënjeve me publikun, zyrtarë të sigurisë etj. të cilët përfshihen në administrimin e muzeve.[16]

Shumica e muzeve lokale në Kosovë menaxhohen nga Qendra Rajonale e Trashëgimisië Kulturore , si instrumente të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporit. Muzeu Kombëtar i Kosovës në anën tjetër funksionon si institucion i veçantë kullturor. Megjithatë, nuk përjashtohen edhe rastet e muzeve të cilat janë nën menaxhimin e institucioneve vartëse të MKRS-së, përkatësisht Institutit Arkeologjik të Kosovës si dhe të organeve të nivelit lokal, siç janë drejtoritë komunale të kulturës dhe turizmit.

[15] Brittanica, “Museums Structur and Operation”, qasur në Nëntor, 2022 https://www.britannica.com/topic/museum-cultural-institution/Museum-structure-and-operations

[16] Ibid.

QASSHMËRIA DHE DIVERSITETI

Një muze i qasshëm nënkupton të qenit i hapur për të gjitha kategoritë e vizitorëve, duke e bërë kështu përmbajtjen e zhvilluar të komunikueshme, rrjedhimisht arritja e qasshmërisë së plotë tashmë është një mision i përcaktuar dhe zhvilluar tashmë ndërkombëtarisht. Megjithatë, shume hulumtime dëshmojnë se personat me aftësi të kufizuara ende në të shumtën e rasteve rezultojnë të jenë të privuar në qasshmërinë e tyre në institucionet kulturore, siç janë muzetë[17].

Institucionet muzeale duhet të ndërmarrin nisma për adaptimin e tyre për qasshmëri të plotë, duke u nisur nga eliminimi i barrierave fizike në ndërtesa, por poashtu edhe në shërbimet që ato ofrojnë, kësisoji të jenë të qasshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Rekomandimet kryesore mund të listohen si mëposhtë:

- Për të verbërit dhe personat me shikim të dobësuar duhet të sigurohen pllaka taktile, shkallë të përshtatshme për lëvizje dhe të pajisura me doreza dhe shenjëzues, audio informues dhe shënime informuese në alfabetin e Brail-it.
- Për të shurdhërit dhe personat me dëgjim të dobësuar duhet të sigurohen paisje për asistencë në dëgjim dhe interpretim vizuel.
- Për personat me aftësi të kufizuara fizike duhet të sigurohen pulte informuese të ulëta dhe të dimensionuara për nevojat e personave në karrocë, karroca lëvizëse ndihmëse, rampa dhe ashensorë, hapësira të dimensionuara në mënyrë të tillë që mundësojnë lëvizjen e personave në karrocë.
- Për personat me dëmtim kognitiv duhet të ofrohen piktograme univerzale

[17] Montsho, G., "Making Museums Accessible to Those With Disabilities", Museum Next, 2022, qasur në Nëntor, 2022 https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-those-with-disabilities/

- Për personat me autizëm duhet të ofrohen hapësira të qeta

Në Kosovë, qasshmëria në institucionet muzeale, duke qenë se ato i takojnë spektrit të institucioneve publike, duhet të rregullohet bazuar në Udhëzimin Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara[18].

Fig. 5 Raste të qasshmërisë në muzetë botërore: a. qasshmëria fizike pa barriera, b. përdorimi i alfabetit të Brail-it.





[18] EC Ma Ndryshe, "Udhëzim Administrativ - për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara", 2016, qasur në Nëntor, 2022, https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153_udhezimi_administrativ.pdf

3. Institucionet Muzeale në Kosovë

Është evidente se ekziston një numër i konsiderueshëm i insitucioneve muzeale në Republikën e Kosovës, megjithatë ka mungesë të statistikave apo një databaze shtetërore lidhur me numrin e tyre, llojin e eksponateve, vendndodhjen gjeografike dhe numrin e vizitorëve. Muzeu Kombëtar i Kosovës si një ndër ndërtesat më të vjetra kulturore dhe historike në Kosovë (1949) konsiderohet të jetë në rradhën e muzeve më domininant në kuadër të institucioneve muzeale të Kosovës[19].


Krahas Muzeut Kombëtar, i cili për qëllim ka ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, në të gjitha qendrat më të mëdha të Kosovës operojnë muzetë e qyteteve. Këta të fundit variojnë për nga kategorizimi, duke funksionuar kryesisht si muze të përgjithshëm rajonal, muze të historisë, muze etnologjik dhe muze arkeologjik.

Fig. 6 Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë.



[19] Manifesta14, "Muzeu i Kosovës", qasur në Nëntor 2022, https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/

Fig. 7 Ilustrim i muzeve të Kosovës.





4. Muzetë e qytetit të Mitrovicës

Qyteti i Mitrovicës numëron gjithsej tre muze:

(1) **Muzeu i Qytetit/Muzeu i Mitrovicës,**
(2) **Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve - TREPÇA dhe**
(3) **Kompleksi i Kullave Isë Boletini (i cili operon si muze).**

Institucionet muzeale të Mitrovicës trajtojnë, ruajnë dhe prezentojnë koleksione nga qyteti dhe rajoni i Mitrovicës. Për nga fushëveprimi Muzeu i Qytetit përmban artefakte e eksponate të historisë, arkeologjisë, etnologjisë etj. Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA, përmban artefakte dhe eksponate gjeologjike dhe historike të lidhura me zhvillimin e minierës së Trepçës.
Ndërsa Kompleksi i Kullave Isë Boletini përfshinë dhjetëra artefakte, historikun e shkruar të Isë Boletinit, ku dhe vetë kompleksi flet për historinë e rezistencës dhe heroizmit të kësaj familjeje.Sipas hulumtimit fillestar të inicuar në kuadër të kësaj analize, është vërtetuar se të tre muzetë ekzistues të qytetit të Mitrovicës operojnë në baza të rregullta ditore, çdo ditë pune dhe me raste të veçanta të festave apo organizimeve të tjera hapen edhe gjatë ditëve të pushimit.

Fig. 8 Muzetë e Mitrovicës 1-3.








4.1. Gjendja ekzistuese e strukturave fizike

Muzetë e qytetit të Mitrovicës operojnë në ndërtesa arkitektonike në gjendje relativisht të mirë fizike. Muzeu i Qytetit operon në ndërtesën adaptuar të Ish Armatës Jugosllave, përkatësisht në përdhesë të kësaj ndërtese, pasiqë kati i saj i parë për momentin shfrytëzohet nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Muzikës "Tefta Tashkko". Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA operon në një ndërtesë të destinuar për muze, e ndërtuar në vitin 2012; megjithëse relativisht e re, ndërtesa nuk i përmbush disa kërkesa themelore dhe ka filluar të dëmtohet. Ndërsa Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit gjendet në fshatin Boletin, dhe si kompleks ka gjendje fizike të mirë, megjithëse kërkesat për intervenim janë të shprehura për shkak të komplikimeve që vijnë nga dëmtuesit natyror më të theksuar në këtë zonë.

Fig. 9 Hartëzim i institucioneve muzeale të përfshira në hulumtim.



(1) KOMPLEKSI I KULLAVE TË ISË BOLETINIT

Kulla e Isa Boletinit gjendet në fshatin Boletin, 10 km në verilindje të Mitrovicës, përkatësisht në komunën e Zveçanit, në 900m lartësi mbidetare. Ky fshat ishte thuajse i pabanuar deri në vitet 1700-1800, kur migruan familja Maksutaj nga fisi Shalë, të cilët ishin nga fshati Isniq i Deçanit. Më vonë kjo familje mori mbiemrin Boletini, pra familja e heroit Isa Boletini. Admirimi dhe lidhja shpirtërore e tij me Boletinin ishte aq e madhe, sa që për gurët e këtij fshati Isa Boletini shprehej kështu: "*Ma i mirë asht për mua Boletini im me ata gurë, se sa sarajet e Stambollit*". [20]

Fig. 10 Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit; ortofoto.



Kompleksi është ngritur në fund te shekullit XIX. Gjatë luftërave që u zhvilluan kompleksi u shkatërrua tre herë përgjatë viteve 1830-1832, 1908 dhe 1912. Brenda kompleksit gjendet kulla e burrave dhe e grave, si dhe shihet guri i madh me vrimat e topave të shkaktuara prej luftërave që janë bërë në Boletin. Kulla e burrave është djegur gjashtë herë dhe nga gërmadhat e saj mund të shihet niveli i luftërave të Boletinit. Kulla e grave e cila është ndërtuar para vitit 1912 me gurët e punishtes së Boletinëve dhe i ka rezistuar kohës, duke shërbyer si shkollë fillore e fshatit Boletin gjatë viteve 47-70. Nga vitet e 70-ta kulla kishte qenë në gjendje të rënduar, ndërsa restaurimi i saj është realizuar në vitin 2005. Gjatë restaurimit është ruajtur mirë origjinaliteti i saj, me vetëm disa ndryshime që është dashur të realizohen patjetër.[21]

Ana perëndimore e këtij kompleksi është e rrethuar me mure mbrojtëse, me një terren të pjerrët, ndërsa pjesa lindore pa mur mbrojtës ishte e përshtatshme për vrojtim. Oborri i kullave është i rrethuar me mur i punuar nga gurët e gdhendur, me frënxhi, si dhe me një oxhak. Në mes të Kullës është një shtyllë e përbërë nga një gurë i vetëm. Sipas arkitektit Gani Gashi ky është nje rast i rallë i arkitekturës së asaj kohe dhe që ai nuk e ka hasur në kulla të tjera të Kosovës.

[20] Azizi, Ismet. 2020. Kosova për Sanxhakun. Korrik 25. Qasur në Janar 10, 2024. https://kosovapersanxhakun.org/e-ndertuar-per-te-mbijetuar-kulla-e-ise-boletinit/.
[21] 2021. *RTK Story - Kulla e Isa Boletinit 10.05.2021.* 10 Maj. Qasja Janar 10, 2024. https://www.youtube.com/watch?v=-_lPJMV7_Es.

(2) MUZEU SHTETËROR I KIRSTALEVE DHE MINERALEVE - TREPÇA

Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve - TREPÇA është themeluar në vitin 1964 në Stantërg të Mitrovicës. Bazuar në bukuritë mahnitëse të kristaleve, ka ekzistuar ideja e themelimit të muzeut të kristaleve atje. Në atë kohë kishin filluar grumbullimet e para të mineraleve dhe më pas vendosja e tyre në muze. Fillimisht, numri i nxjerr i kristaleve ishte i vogël, mirëpo me kalimin e kohës ky numër erdhi duke u rritur deri në ditet e sotme. Numri i kristaleve të nxjerra nga vendburimi Trepça është i madh dhe vështirë të dihet numri i saktë i tyre.[22]

Fig. 11 Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve – Trepça; ortofoto.



Muzeu sot përmban rreth 2 mijë eksponate të ekspozuara nga minerale të ndryshme deri tek mostra të prodhimit të Trepçës gjatë shekullit të kaluar, mjete të punëtorëve etj. 95% e eksponateve janë të minierës së Trepçës, ndërsa ka edhe nga zona të tjera të Kosovës, nga shtetet fqinje, e madje edhe nga vende të tjera të botës si: Portugalia, Maroku, Brazili, Japonia etj.

Gjatë 2011-2012 u realizua ndërtesa e dedikuar për shërbime muzeale të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve - TREPÇA në Stantërg, në afërsi të ish-ndërtesës ku qe vendosur fillimisht muzeu. Ky projekt ishte iniciativë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministrisë së Ekonomisë. Kështu prej vitit 2012 muzeu operon në këtë ndërtesë e cila megjithëse e re, nuk i përmbush të gjitha kërkesat e këtij institucioni.

[22] Qershor, 2012. «Trepça gjatë vitit 2011-2012.» *Trepça-Me fat* 6

(3) MUZEU I QYTETIT

Muzeu u themelua në vitin 1952. Si institucion i kulturës është njëri ndër institucionet më të hershme në Qytetin e Mitovicës. Muzeu u themelua për hulumtimin, grumbullimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale të regjionit të Mitrovicës. Në fillimet e veprimtarisë së tij, Muzeu i Mitrovicës është pasuruar me koleksionin e fosileve. Gjatë kësaj periudhe filluan gërmimet arkeologjike në disa lokalitete në Mitrovicë, gërmime që rezultuan me mijëra gjetje arkeologjike, dhe pjesa tjetër e koleksionit u pasurua nga puna dhe angazhimi i stafit profesional në krye me themeluesin e këtij institucioni drejtorin e parë të muzeut, z.Sylejman Murati. Fillimisht muzeu ishte i vendosur në objektin e vjetër të komunës, kurse në vitin 1960 punën dhe veprimtarine e tij e vazhdoi në objektin e Hamamit të Qytetit. Që nga viti 2009 muzeu e ushtron veprimtarinë e tij në objektin e ish-Shtepisë së Armatës Jugosllave në Mitrovicë.[23]

Fig. 12 Muzeu i Qytetit; ortofoto.



Objekti i ish-Armatës Jugosllave është ndërtuar për nevoja ushtarake në vitin 1959 me stil arkitektonik modernist. Për momentin përdhesa e kësaj ndërtese shfrytëzohet nga Muzeu i Qytetit, ndërsa kati shfrytëzohet nga Shkolla Fillore e Mesme e Muzikës “Tefta Tashko”. Ndërtesa e re adekuate për kërkesat e shkollës së muzikës është duke u ndërtuar, kështu që së shpejti ndërtesa do të operoj vetëm si muze.

Ky objekt është pjesë e memories kolektive të qytetit, ngase që prej viteve të '70 ky objekt u përdor nga shumë organizata për realizimin e aktivitete të ndryshme kulturore. Pas luftës së fundit në Kosovë, u shfrytëzua nga komanda e KFOR-it Francez e më pas edhe nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Në vitin 2017 për shkak të historisë që prezanton si dhe vlerave arkitektonike që përfaqëson, vjetësisë dhe memories kolektive që komuniteti ka për të, ka hyrë në listën e ndërtesave të mbrojtura me ligj.[24]

---

[23] Stafi profesional i Muzeut të Mitrovicës. 2022. *Digjitalizimi i Muzeut të Mitrovicës / Mundësimi i shëtitjes virtuale.* 06 Prill. Qasja Shkurt 02, 2024. https://lapsi360.com/MuzeuiMitrovic%C3%ABs/.

[24] Ibid.

4.2. Operimi i muzeve, kapacitetet njerëzore dhe shërbimet e ofruara

Muzetë e analizuar dhe diskutuar në kuadër të këtij hulumtimi rezultojnë të jenë të menaxhuar nga niveli lokal dhe ai qëndror. Më konkretisht Muzeu i Qytetit të Mitrovicës, është nën menaxhimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, komuna e Mitrovicës. Muzeu Shtëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA është nën menaxhimin qëndror, përkatësisht të Agjencisë Gjeologjike të Kosovës; Ministria e Ekonomisë, ndërsa Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit menaxhohet nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore të Mitrovicës, si institucion bartës i MKRS-së.

Në kuadër të këtij hulumtimi, fillimisht janë adresuar shkresa zyrtare në secilin institucion që menaxhon muzeun përkatës, për të kuptuar dhe mbledhur të dhëna rreth numrit dhe llojeve të eksponateve, stafit aktual shërbyes si dhe shërmbimeve të ofruara aktualisht nga muzeu në fjalë. Rrjedhimisht, bazuar në të dhënat e pranuara me shkrim, dhe poashtu në vrojtimet dhe analizat në terren nga ana e hulumtuesve, janë përpiluar kartelat informuese të prezentuara si më poshtë.

SHËNIM: Në kuadër të këtij hulumtimi mungon kartela informuese për Muzeun e Qytetit, duke qenë se EC nuk ka pranuar përgjegje në pyetjet e adresuara.

KARTELË INFORMUESE - (1) KOMPLEKSI I KULLAVE TË ISA BOLETINIT	
Emërtimi	Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit
Viti i themelimit	2004
Kategoria	Muze Historik
Administrimi	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporit; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore
Sipërfaja e parcelës	?
Sipërfaqja e ndërtesës	?
Modaliteti i operimit	I hapur për vizitorë
Numri i vizitorëve në vitin 2022	5.753
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Shtator 2023	5.526
Numri dhe lloji i eksponateve	Në Kompleksin e Kullave të Isa Boletinit gjenden 50 eksponate të luajtshme të cilat janë inventarizuar dhe dokumentuar në vitin 2016. Në katin përdhes është e vendosur ekspozita e destinura për publikun, kushtuar jetës dhe veprës të heroit kombëtar Isë Boletini dhe bashkëfamiljarëve të tij. Objektet e luajtshme të lartë cekura janë të ekspozuara në katin e I-rë (P+1).
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar	Stafi i angazhuar në Kompleksi i Kullës Isë Boletini janë staf teknik (gjithsej 4), 1 Mirëmbajtës i Kullës 3 Roje të Objektit
A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Për vitin 2023 nuk ka pasur kalendar vjetor, nga viti 2024 parashihet edhe kalendari vjetor.
A ofron shërbime të ciceronëve?	Po. Edhe pse me Kontratë është si Roje e Objektit shërbimin e ciceronit në këtë Kompleks e ushtron familjari zt. Gazmend Boletini
A posedon shenjëzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Ekspozita përmban narracionin adekuat ndërsa eksponatet janë pjesërisht të shenjëzuara
A ofron interpetues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Jo

KARTELË INFORMUESE - (2) MUZEU SHTETËROR I KRISTALEVE DHE MINERALEVE-TREPÇA	
Emërtimi	Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA
Viti i themelimit	1964
Kategoria	Muze gjeologjik
Administrimi	Agjencia Gjeologjike e Kosovës; Ministria e Ekonomisë
Sipërfaja e parcelës	6759.06 m2
Sipërfaqja e objektit	476.36 m2
Modaliteti i operimit	I hapur për vizitorë
Numri i vizitorëve në vitin 2022	Mbështetur në numrin e regjistruar të vizitorëve në vitin 2022, MSHKM "Trepça" e kanë vizituar gjithsej 6000 vizitorë
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Shtator 2023	Në periudhën janar-shtator të vitit 2023 numri i vizitorëve të cilët kanë vizituar MSHKM "Trepça" janë 4960 vizitorë.
Numri dhe lloji i eksponateve	Në hapësirat e Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça janë të ekspozuar mbi 2000 minerale, ndërsa mineralet dhe kristalet të emëruara janë gjithsejtë 1860. Minerale të pa ekspozuara, të cilat janë duke u trajtuar dhe disa minerale me përbërje metalore, të cilat e kanë humbur strukturën kristalore të mirë dhe nuk kanë vlerë për ekspozim për shkak të oksidimit të tyre janë 20 minerale.
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar	Numri i të punësuarve në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve "Trepça" është shtatë, ndërsa numri i të punësuarve me përgatitje shkollore universitare janë tre me gradën Master Gjeolog, një teknik për trajtimin dhe mirëmbajtjen e mineraleve me përgatitje shkollore të mesme dhe tre staf mbështetës të sigurimit të objektit me përgatitje të mesme shkollore.

A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Kalendari vjetor të aktiviteteve Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça” kryesisht bazohet në aktivitetet që kanë te bëjnë me mbledhjen, ekspozimin, ruajtjen, analizimin dhe përpunimin në mënyrë profesionale dhe shkencore, sistematizimin në grupe, mbrojtjen e përhershme të mineraleve/kristaleve dhe dokumentacionit të muzeut. Prandaj, bazuar në Rregulloren (ZKM) Nr.05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Muzeu Shtetërore i Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça” është pjesë e strukturës së brendshme të SHGJK-së.
A ofron shërbime të ciceronëve?	Po
A posedon shenjëzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Po
A ofron interpetues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Po

4.3. Analiza e hapësirave dhe sekuencat e lëvizjeve

Për të tri muzetë është bërë analiza e tipologjive të hapësirave ekspozuese ne relacion me sekuencat e lëvizjes së vizitorëve. Kjo me synimin e të kuptuarit të veçorive hapësinore që ato bartin dhe identifikimit të mangësive potenciale në kuadër të organizimit funksional si dhe kushteve tjera të cilat si muze ato duhet t'i përmbushin (të specifikuara në kapitullin 3).

Muzetë aktual të Mitrovicës paraqesin tipologji të ndryshme të hapësirave ekspozuese, dhe është e vështirë të pozicionohen në njërën ndër tipologjitë e përcaktuara në kuadër të normativave të projektimit të ndërtesave muzeale. Kjo derivon edhe nga fakti se Muzeu i Qytetit dhe Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit, për dallim nga Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA janë përcaktuar të operojnë në kuadër të ndërtesave ekzistuese të trashëgimisë kulturore, dhe jo të projektuara fillimisht për të patur këtë destinim (siç është MSHKM-TREPÇA).




Megjithëkëtë, sekuencat e lëvizjes janë lehtë të identifikueshme nga vizitorët, për shkak të organizimit funksional të qartë të kthinave dhe lehtë të lexueshëm, siç shihet në shtojcën grafike në vazhdim.

Përpos analizave në tipologjitë e hapësirave, thellësinë e tyre dhe shtrirjen funksionale të ndërtesave muzeale të bëra në gjendjen ekzistuese, në kuadër të këtij hulumtimi është bërë edhe analiza e lëvisshmërisë së vizitorëve për dy nga muzetë e hulumtuar; Muzeun e Kompleksit të Kullave të Isë Boletinit dhe Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça. Lëvizshmëria e vizitorëve nuk është analizuar në rastin e Muzeut të Qytetit, duke qenë se i njejti ka rezultuar në renovim në periudhën e realizimit të këtij hulumtimi.

Numërimet dhe përcjellja e vizitorëve në muzetë e analizuara është bërë në intervale kohore një orëshe, në tri periudha të ndryshme të ditës. Analiza e lëvishmërisë është bërë në bazë të vrojtimit në periudha të caktuara kohore, rastisjes së vizitorëve, si dhe informatave të mbledhura nga ciceronët e muzeve.

Sipas të dhënave e mbledhura; trajektoren e lëvizshmërisë së vizitorëve dhe identifikimin e hapësirave me më së shumti interes për tu vizituar nga ana e viziotorëve janë prezentuar në ilustrimet e mëposhtme dhe poashtu, në mënyrë më të detajuar, në shtojcën grafike.

Fig. 13 Tipologjitë e hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale të Mitrovicës në relacion me lëvizjen e publikut.

KOMPLEKSI I KULLAVE TË ISA BOLETINIT		Qendror
MUZEU SHTETËROR I KRISTALEVE DHE MINERALEVE-TREPÇA		Linear
MUZEU I QYTETIT		Kompleks, linear

4.4. Qasshmëria e personave me aftësi të kufizuara

Në aspektin e qasshmërise fizike, bazuar në Udhëzimin Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe në krahasueshmëri me rekomandimet ndërkombëtare mbi qasshmërinë gjithëpërfshirëse në institucionet muzeale, kjo analizë nxjerr të dhëna që MSHKM-Trepça dhe Muzeu i Qytetit janë të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit jo, kryesisht për shkak të fizionomisë së lokacionit.

Në aspektin e shërbimeve tjera, muzetë ende nuk ofrojnë shërbime vizuele dhe asistencë në interpretim për personat e shurdhër dhe me pengesa në dëgjim. Poashtu është e identifikueshme mungesa e sqarimeve të ekspozitave në alfabetin e Brail-it. Një tjetër mungesë është asistenca për personat me dëmtim kognitiv dhe me autizëm. Sa i përket aksesueshmërisë fizike, muzetë e analizuar rezultojnë të jenë pjesërissht të qasshëm, me prezencë të pengesave eventuale dhe barrierave fizike. Pengesat e përgjithshme konsistojnë në mungesën e rampave, platformave apo ashensorëve për komunikim vertikal si dhe në mungesën e toaleteve për PAK.

- Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit ka kufizime në qasshmëri fizike përshkak të fizionomisë së lokacionit dhe ndërtesës dy katëshe e cila është adaptuar në muze nga funksioni i saj origjinal si kullë banimi. Në oborr janë identifikuar dy disnivelime më të theksuara, dhe disa të tjera më të vogla. Disnivelimi i parë është në afërsi të Kullës së Burrave (e cila nuk i ka rezistuar kohës), ndërsa disnivelimi i dytë më i theksuar është në hyrje të Kullës së Grave (sot hapësirë ekspozuese), pra ndërtesës muzeale. Kjo ndërtesë shtrihet në dy etazhe; në përdhesë dhe në katin e parë, i cili mund të ngjitet vetëm me shkallë, pjerrtësia e tyre e madhe e pamundëson ngjitjen me mjete ndihmëse.

- Në Muzeun e Mineraleve-TREPÇA konfigurimi i terrenit që nga hyrja pa pengesa dhe disnivele e mundëson lehtësisht qasjen deri në objekt. Vetë objekti meqë është i ngritur në nivel më të lartë nga niveli zero, është bërë i qasshëm me integrimin e rampës për lëvizje të personave me aftësi të kufizuara. Ndërsa organizimi hapësinor i rafteve dhe vitrinave për ekspozim lë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje brenda objektit, pa pengesa e vështirësi.
- Muzeu i Qytetit, i gjendur në qendrën e Mitrovicës, ka oborr të rrafshët dhe lehtësisht të qasshëm fizikisht. Ndërtesa megjithëse është e ngritur nga niveli zero, mundëson qasjen për personat me aftësi të kufizuara përmes rampës të vendosur në hyrje. Kjo ndërtesë ka edhe një oborr të brendshëm që shfrytëzohet për aktivitete të hapura, i cili është poashtu i qasshëm përmes një pjerrine që mundëson qasjen nga korridori në atrium.

Përfundime dhe rekomandime

Muzetë kanë një rol vital për shoqërinë, duke mbajtur epitetin e institucioneve të cilat hulumtojnë, mbledhin, koservojnë, ekspozojnë dhe intepretojnë trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme të një shteti. Si të tilla, institucionet muzeale nxisin shkëmbimin e vlerave dhe kontribuojnë në krijimin e identitetit kolektiv. Muzetë sipas koncepteve dhe standardizimeve ndërkombëtare, duhet të jenë të hapura për publikun, të qasshme për të gjithë, të ofrojnë shërbime përcjellëse, të nxisin vizita të vazhdueshme të vizitorëve vendas e të huaj, si dhe të ofrojnë edukim, rekreim dhe mundësi për ngritjen e të menduarit dhe shkëmbimin e ideve. Në këtë kontekst muzetë janë hapësira që tejkalojnë funksionin tradicional, ato shërbejnë si një ambient ku kreativiteti, mendimi kritik, diskutimi e reflektimi gjejnë hapësirën dhe koekzistojnë, duke ofruar një platformë që nxit dialogun dhe zhvillimin intelektual të vizitorëve.

Qyteti i Mitrovicës, si një qytet me identitet të lashtë kulturor, artistik e industrial, posedon tre muze të cilët dëshmojnë mjaft mirë larmishmërinë e natyrës së qytetit, dhe pasurinë kulturore, historike, shkencore e gjeologjike. Vlerat e qytetit mund të plasohen më së miri përmes një platforme siç janë muzetë. Megjithatë, kjo analizë e ndërmarrë në tre muzetë kryesore të qytetit të Mitrovicës, tregon se ka sfida në operimin e tyre efektiv. Krahas potencialit të madh që mbartin si institucione muzeale në aspektin e ekspozitave që ofrojnë për publikun, është evidente nevoja për përmirësim në mënyrën e tyre të funksionimit dhe ndërlidhjen me publikun. Nisur nga kjo, qyteti i Mitrovicës ka mundësi të përmirësojë eksperiencën muzeale për vizitorët.

Mëposhtë mund të listohen disa përfundime të realizuara nga aktivitetet hulumtuese të ndërmarra në të tri institucionet muzeale të qytetit të Mitrovicës:

1. ***Institucionet muzeale të qytetit të Mitrovicës kanë dokumentacion të operimit arkitektonik, por mungon një dokumentim i ekspozitave aktuale.*** Më specifikisht, Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve - TREPÇA, ka dokumentacionin e projektit arkitektonik në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë. Krahas tij edhe Muzeu i Qytetit është dokumentuar së fundmi në kuadër të lëndës "Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturale" nga studentët e Fakultetit të Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës. Ndërsa Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit është dokumentuar pas restaurimit të vitit 2005 dhe dokumentacioni arkitektonik është gjetur në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Mitrovicë. Krahas kësaj, ky hulumtim përmbledh për herë të parë në një dokument të vetëm dokumentimin arkitektonik të tre muzeve bashkarisht me prezentimin e mobilarit aktual (me përjashtim të Muzeut të Qytetit ku nuk është dokumentuar mobilari ekspozues për shkak të gjendjes aktuale në renovim) në të cilin janë të vendosura eksponatet aktuale. Ky dokumentim do të mund të shërbëjë në cilëndo iniciativë të MKRS-së apo KKP-së për ristrukturim dhe ridizajnim të strukturave ekzistuese të institucioneve muzeale të Mitrovicës.

2. Nga tre muzetë aktual, Muzeu i Qytetit posedon faqe zyrtare në internet, ndërsa të tre muzetë janë poashtu të angazhuar në promovimin e tyre në media sociale (Facebook dhe Instagram) aspekt ky që lehtëson informimin e qytetarëve për aktivitetet që këta muze zhvillojnë dhe gjithashtu ndikon në promovimin e vlerave dhe programeve të tyre. Krahas kësaj Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA dhe Muzeu i Qytetit janë të prezentuar edhe në platformat ekzistuese të institucioneve prej të cilave administrohen. Kjo e dhënë e identifikuar përgjatë mbledhjes së materialit hulumtues, dëshmon për

faktin se muzetë aktuale të qytetit të Mitrovicës kanë ndjekur trendin e promovimit përmes mediave sociale dhe qasshmërisë vizuale, duke mundësuar informim më të lehtë dhe tërheqje të qytetarëve e turistëve në përgjithësi. Megjithatë duke ditur rëndësinë e lartë të promovimit në platforma dixhitale, është e rëndësishme që të gjithë muzetë të mbështeten edhe më tutje në këtë drejtim.

3. Sa i përket të dhënave statistikore lidhur me numrin e vizitorëve të muzeve çdo vit ende nuk ka një databazë të hapur online. Ky fakt shpërfaqet si një sfidë në aktivitetin hulumtues apo analizat e mundshme lidhur me gjendjen aktuale të muzeve të Mitrovicës me qëllim të identifikimit të problematikave dhe potencialeve që këto ndërtesa bartin. Lidhur më këtë, ky hulumtim ka prezentuar të dhëna të siguruara përmes shkresave zyrtare në institucionet muzeale aktuale, duke vënë në pah që të dhëna të tilla mund të krijojnë një pasqyrë më të qartë për secilin hulumtues, dhe se një mungesë e tillë mund të adresohet në të ardhmën nga institucionet përkatëse.

4. Muzetë e qytetit të Mitrovicës qëndrojnë të hapur gjatë periudhës së tërë vitit, ndërsa Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA dhe Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit për shkak të venddodhjes së tyre, pranojnë paraprakisht edhe lajmërime për vizita të organizuara.
Të tre muzetë operojnë në orar të rregullt, të hapur pesë deri në gjashtë ditë në jave, në tetë orë pune. Në raste festash Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit pranon vizitorë edhe jashtë orarit të rregullt të punës, varësisht nga kërkesa dhe delegacioni. Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi, mund të thuhet se një indikatorë fundamental në funksionimin e mirëfilltë të këtyre muzeve dhe shërbimit që ata ofrojnë janë resurset humane.

5. Muzetë e qytetit të Mitrovicës janë mjaft aktivë në zhvillimin e programeve kulturore dhe interaktive për publikun. Një model i kësaj është Muzeu i Qytetit, i cili përmes ofrimit të

hapësirës për aktivitete të shumta me natyrë muzikore, edukative, kulturore, krijon një hapësirë interaktive për vizitorë. Diskutime publike, netë poezish, netë muzikore, ekspozita të përkohshme e aktivitete të tjera shpesh zënë vend në hapësirat e këtij muzeu, aspekt ky që ndikon në promovimin e tij si një hapësirë gërshetimi e vlerave historike, dhe kulturës së trendit aktual. Dy muzetë e tjerë janë më aktiv në zhvillimin e vizitave të organizuara të nxënësve dhe delegacioneve të ndryshme. Autoritete të ndryshme, personalitete të shquara të skenës politike, kulturore e artistike janë shënuar si vizitorë të këtyre muzeve. Poashtu si shkak i natyrës specifike Muzeu i Kristaleve-TREPÇA njihet si një pikë vizite për shumë hulumtues të huaj, gjeologë, punëtorë minierash etj.

6. Muzetë e qytetit të Mitrovicës kanë të integruar në programin e tyre aktivitete me tendencë drejt një përshtatshmërie me konceptet e reja të institucioneve muzeale. Trendet botërore dëshmojnë se institucionet muzeale tregohen shumë më të suksesshme kur funksioni i tyre primar i ekspozimit gërshetohet me angazhimin e komunitetit, përfshirjen e tyre në aktivitete, dinamikën e vizitës etj. Në paralele me këtë aspekt, vizitat dhe analizat e këtij hulumtimi na lënë të kuptojmë se në muzetë e Mitrovicës me përjashtim të muzeut të Kristaleve - TREPÇA, zhvillohen aktivitete të ndryshme që angazhojnë komunitetin jo vetëm për një vizitë të shkurtë po edhe më gjatë. Këtë e mundësojnë vizitat e organizuara të grupeve të nxënësve, studentëve, që në kuadër të vizitave realizojnë edhe pjesë të agjendës së tyre mësimore, të prodhimit të dijes dhe informacionit. Trendet e reja të institucioneve muzeale synojnë që hapësirat e muzeve të kthehen në mjedise për zhvillim të projekteve, biblioteka, galeri e salla ekspozimi dhe të jenë institucione të pajisura me teknika bashkëkohore të prezentimit dhe ekspozimit.

Gjithashtu, përmes analizave në terren, procesit të bisedave me profesionistët udhëheqës të këtyre institucioneve, dhe

mbledhjes së informatave nga burime të ndryshme ky hulumtim nxjerrë edhe këto rezultate të vlerësura si më sfiduese:

7. Nuk ekziston një model unik, me qëllime të definuara qartë dhe me vizion të unifikuar për aministrimin aktual dhe të ardhmen e muzeve të qytetit të Mitrovicës, duke qenë se administrimi i tyre bëhet në një modalitet të përzier, nga niveli qendror dhe lokal. Përderisa Muzeu i Qytetit administrohet nga DKRS në Mitrovicë, Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA administrohet nga Agjencia Gjeologjike e Kosovës; Ministria e Ekonomisë, ndërsa Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit administrohet nga QRTKM; MKRS.
Ky hulumtim nxjerr në pah se mungesa e një modeli unik të menaxhimit, i cili do të unifikonte objektivat menaxheriale dhe operuese, u ka kushtuar muzeve aktuale të qytetit të Mitrovicës në drejtim të mungesës së një brendimi të unfikuar, politikave të përbashkëta për tërheqjen e vizitorëve dhe përfshirjes në kalendarë kulturor dhe pako të përbashkëta turistike.

8. Muzetë e qytetit të Mitrovicës janë pjesërisht të qasshëm për Personat me Aftësi të Kufizuara. Bazuar në analizat e realizuara në terren, muzetë e qytetit të Mitrovicës me përjashtim të Kompleksit të Kullave të Isë Boletinit, rezultojnë të jenë të qasshëm për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky i fundit për shkak të vet konfiguracionit të terrenit që imponon disnivel me shkallë dhe infrastrukturës së pa qasshme për PAK, është i paqasshëm edhe si ndërtesë. Qasshmëria e pjesërishme në muzetë e qytetit të Mitrovicës konsiston jo vetëm në faktin se në këto ndërtesa janë identifikuar barriera fizike, por edhe për faktin se në këto ndërtesa aktualisht nuk ka infrastukturë fizike dhe operacionale edhe për personat e shurdhër, të verbër, persona me zhvillim të vonuar etj.

9. Nuk ekzistojnë shenjëzues në kontekst të gjerë dhe të ngushtë urban lidhur me venddodhjen e muzeve të qytetit të Mitrovicës. Qytetarët në

përgjithësi, dhe turistët në veçanti e kanë të vështirë identifikimin e ndërtesave muzeale të qytetit të Mitrovicës. Këtë fakt e adreson edhe drejtori aktual i Muzeut të Mineraleve-TREPÇA, meqë venddodhja e këtij muzeu e ka domosdoshmëri orientimin e vizitorëve që nga qendra e qytetit. Mungesa e shenjëzuesve është duke ndikuar drejtpërsëdrejti në humbjen e potencialit që muzetë bartin, dhe mund të ketë ndikim edhe në numrin dhe interesimin e vizitorëve potencial.

10. Muzetë e qytetit të Mitrovicës kanë hapësirë për pasurim me tabela informuese lidhur me llojin e eksponateve dhe artefakteve të ekspozuara, emërtimeve burimore të tyre dhe periudhave historike të cilave u takojnë. Mungesa e informatave të shkruara dhe udhëzuesve lidhur me kategorinë e muzeve në përgjithësi, dhe llojin e eksponateve në veçanti (në rastin e Kompleksit të Kullave të Isë Boletinit) ndikon që informatat të merren domosdoshmërisht me praninë e udhëheqësit të këtij muzeu.

Si përfundim, duke u bazuar në potencialet dhe mangësitë e identifikuara, ky hulumtim rekomandon:

- Investimin në përmirësimin e hapësirave ekspozuese dhe gjendjes fizike të muzeve;
- Intervenime në sistemin e ngrohjes/ftohjes, ventilimit dhe ndriçimit për t'i bërë hapësirat më lehtë të vizitueshme për vizitorë, dhe më efikase për vetë stafin punues;
- Pasurimin e përmbajtjeve përcjellëse për muze, siç janë kafenetë, hapësirat për shitjen e suvenireve etj., në mënyrë që të rritet suksesi i muzeve dhe kënaqshmërisë së vizitorëve;
- Definimin e aspektit legjislativ i cili rregullon themelimin dhe funksionimin e muzeve;
- Unifikimin e vizionit dhe objektivave administruese të muzeve të qytetit të Mitrovicës përmes bashkë-punimit në nivel qëndror dhe lokal;

- Krijimin e një platforme interaktive lidhur me muzetë aktuale të qytetit të Mitrovicës, historikun, venddodhjen, llojin e eksponateve dhe ngjarjeve kulturore që ato ofrojnë me qëllim të ofrimit të informacionit online për qytetarët në përgjithësi, dhe turistët në veçanti;
- Zbatimin e masave për të përmirësuar qasshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në të gjitha muzetë, duke adresuar pengesat fizike dhe siguruar infrastrukturë të përshtatshme bashkë me toaletet për PAK;
- Ofrimin e infrastukturës fizike dhe operacionale për personat e verbër, personat e shurdhër, personat me pengesë në zhvillim dhe kategoritë e tjera, drejt arritjes së konceptit të muzeve gjithëpërfshirëse, sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare;
- Ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve intelektuale/profesionale;
- Vendosjen e shenjëzimit në kontekst urban me qëllim të informimit të vizitorëve lidhur me lokacionin e muzeve, llojin, orarin e punës dhe çmimet;
- Dizajnimin dhe vendosjen e tabelave fizike me të të dhënave të shkruara (në gjuhët lokale, në gjuhën angleze dhe në alfabetin e Brail-it) lidhur me kategorinë dhe historikun e muzeut; llojin, emërtimet dhe periudhat e eksponateve me qëllim të përcaktimit të sekuencës së lëvizjes së vizitorëve;
- Adaptimin e koncepteve bashkëkohore në trajtimin e muzeve, përmes integrimit të programeve hulumtuese dhe interaksionit kulturor e aktiviteteve joformale, duke përfshirë organzimin e ngjarjeve kulturore për të gjitha grupmoshat, organizimin e konferencave, simpoziumeve, ekspozitave, promovimeve etj.

Bibliografia

Alexander, E.P., Alexander, M., *"Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums*", Rowman & Littlefield, 2007

Azizi, Ismet. 2020. Kosova për Sanxhakun. 25 Korrik. Qasja Janar 10, 2024. https://kosovapersanxhakun.org/e-ndertuar-per-te-mbijetuar-kulla-e-ise-boletinit/

Brittanica, "Museums Structur and Operation", qasur në Nëntor, 2022 https://www.britannica.com/topic/museum-cultural-institution/Museum-structure-and-operations

Definicioni i ri i muzeve, propozuar nga Këshilli Nërkombëtar i Muzeve (ICM – International Council of Museums), aprovuar në Konferencën e 26-të Gjenerale mbajtur në Pragë, më 24 Gusht 2022, qasur në Nëntor 2022, https://icom.museum/en/news/icom-approves-a-new-museum-definition/

EC Ma Ndryshe, "Udhëzim Administrativ - për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara", 2016, qasur në Nëntor, 2022, https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153_udhezimi_administrativ.pdf

EC Ma Ndryshe, *"Prizreni 'qytet muze' pa muze?",* Maj 2008, qasur në Nëntor 2022 https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530

Ed. Littlefield, D., *"Metric Handbook – Planning and Design Data",* Third Edition, Elsevier Ltd., 2008, fq.450 – 455

2021. RTK Story - Kulla e Isa Boletinit 10.05.2021. 10 Maj. Qasja Janar 10, 2024. https://www.youtube.com/watch?v=-_lPJMV7_Es

Stafi profesional i Muzeut të Mitrovicës. 2022. Digjitalizimi i Muzeut të Mitrovicës / Mundësimi i shëtitjes virtuale. 06 Prill. Qasja Shkurt 02, 2024. https://lapsi360.com/MuzeuiMitrovic%C3%ABs/

Goode, G.B., "On the Classification of Museums", Vol. 3, No. 57 (Jan. 31, 1896), fq. 154-161

Günay, B.,“*Museum concept from past to present and importance of museums as centers of art education”,* International Conference on New Horizons in Education INTE2012, 2012

Jerliu, F., *“Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017 – 2027”,* Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2016

Manifesta14, “Muzeu i Kosovës”, qasur në Nëntor 2022, https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/

MKRS – faqja zyrtare, “Miratohet Koncept-dokumenti për Art dhe Kulturë” qasur në Nëntor, 2022, https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,3041#.Y6bo1i-B2X0

Montsho, G., “Making Museums Accessible to Those With Disabilities”, Museum Next, 2022, qasur në Nëntor, 2022 https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-those-with-disabilities/

Tzortzi, K. *“Museum Space – Where Architecture Meets Museology”,* Routledge, 2016, fq. 11-43

Qershor, 2012. «Trepça gjatë vitit 2011-2012.» Trepça-Me fat 6

Lista e figurave

Fig. 1 Ilustrim i tri institucioneve muzeale të qytetit të Mitrovicës të përshira në hulumtim. (Burimi: Autoret) 4
Fig. 2 Palazzo Medici, muzeu i parë në Evropë. (Burimi: http://www.florencewebguide. 8
Fig. 3 Muzeu Guggenheim, New York (Burimi: https://www.history.com/this-day-in-history/guggenheim-museum-opens-in-new-york-city) 9
Fig. 4 Fig. 3 a. Alte Pinakothek në Munich, b. Altes Museum në Berlin, c. Muzeu Glyptotech në Munich, (Burimi: https://en.wikipedia.org/wiki/Glyptothekhttps://de.wikipedia.org/wiki/Altes_Museum#/media/Datei:Altes_Museum,_Berlin_2012.jpg) ..... **Error! Bookmark not defined.**
Fig. 5 a.) Muzeu i Artit, Vienë, b.) Muzeu Arkelogjik, Izrael, c.) Muzeu i Historisë së Natyrës, Los Agelos (Burimi: https://www.sothebys.com/en/museums/kunsthistorisches-museum-wien 10

Fig. 6 Tipologjia hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale në relacion me lëvizjen e publikut (Burimi: Metric Hanbook) 12
Fig. 7 Raste të qasshmërisë në muzetë botërore: a. qasshmëria fizike pa barriera,..15
Fig. 8 Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë (Burimi: https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/).....16
Fig. 9 Ilustrim i muzeve të Kosovës. (Burimi: Autoret) 17
Fig. 10 Muzetë e Mitrovicës 1-3. (Burimi: Autoret).....20
Fig. 11 Hartëzim i institucioneve muzeale të përfshira në hulumtim. (Burimi: Autoret) 22
Fig. 12 Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit, ortofoto. (Burimi: Geoportal Kosova).....23
Fig. 13 Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve – Trepça, ortofoto (Burimi: Geoportal Kosova).....24
Fig. 14 Muzeu i Qytetit, ortofoto. (Burimi: Geoportal Kosovo).....25
Fig. 15 Tipologjitë e hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale të Mitrovicës në relacion me lëvizjen e publikut. (Burimi: Autoret) 44

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatësdhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1.Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshmë statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,

2.Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe


3.Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme.

Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.
Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.



PJESA GRAFIKE

SHTOJCA 1: DOKUMENTIMI DHE ANALIZA E INSTITUCIONEVE MUZEALE TË QYTETIT TË MITROVICËS

PJESA GRAFIKE

PËRMBAJTJA

MUZEU I KOMPLEKSIT TË KULLAVE TË ISË BOLETINIT 01

MUZEU SHTETËROR I KIRSTALEVE DHE MINERALEVE - TREPÇA 02

MUZEU I QYTETIT 03



- SITUACIONI, VENDOSJA NË KONTEKST URBAN
- PLANIMETRITË/ PRERJE / FASADA
- DOKUMENTIMI I GJENDJES EKZISTUESE/ FOTOGRAFITË
- IDENTIFIKIMI I PENGESAVE NË QASSHMËRI
- ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE
- ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE


1
2
3
LEGJENDA:
1. MUZEU I KOMPLEKSIT TË KULLAVE TË ISË BOLETINIT
2. MUZEU SHTETËROR I KRISTALEVE DHE MINERALEVE - TREPÇA
3. MUZEU I QYTETIT

MITROVICA

2004

MUZEU I KOMPLEKSIT TË
KULLAVE TË ISË BOLETINIT



1964

MUZEU SHTETËROR I KIRSTALEVE
DHE MINERALEVE - TREPÇA



1952


MUZEU I QYTETIT



01



MUZEU I KOMPLEKSIT TË KULLAVE TË ISË BOLETINIT




MUZEU I KOMPLEKSIT TË KULLAVE TË ISË BOLETINIT

Kulla e Isa Boletinit gjendet në fshatin Boletin, 10 km në verilindje të Mitrovicës, përkatësisht në komunën e Zveçanit, në 900 m lartësi mbidetare. Ky fshat ishte thuajse i pabanuar deri në vitet 1700-1800, kur migruan familja Maksutaj nga fisi Shalë, të cilët ishin nga fshati Isniq i Deçanit. Më vonë kjo familje mori mbiemrin Boletini, pra familja e heroit Isa Boletini. Admirimi dhe lidhja shpirtërore e tij me Boletinin ishte aq e madhe, saqë për gurët e këtij fshati Isa Boletinit shprehej kështu: "Ma i mirë asht për mua Boletini im me ata gurë, se sa sarajet e Stambollit".


Kompleksi është ngritur në fund te shekullit XIX. Gjatë luftërave që u zhvilluan kompleksi u shkatërrua tre herë përgjatë viteve 1830-1832, 1892, 1895, si dhe dy herë gjatë fillimit të shek. XX, përkatësisht në vitin 1908 dhe 1912. Brenda kompleksit gjendet kulla e burrave dhe e grave, si dhe shihet guri i madh me vrimat e topave të shkaktuara prej luftërave që janë bërë në Boletin. Kulla e burrave është djegur gjashtë herë dhe nga gërmadhat e saj mund të shihet niveli i luftërave të Boletinit. Kulla e grave e cila është ndërtuar para vitit 1912 me gurët e punishtes së Boletinëve i ka rezistuar kohës, duke shërbyer si shkollë fillore e fshatit Boletin gjatë viteve 47-70. Nga vitet e 70-ta kulla kishte qenë në gjendje të rënduar, ndërsa restaurimi i saj është realizuar në vitin 2005. Gjatë restaurimit është ruajtur mirë origjinaliteti i saj, me vetëm disa ndryshime që është dashur të realizohen patjetër.

Ana perëndimore e këtij kompleksi është e rrethuar me mure mbrojtëse, me një terren të pjerrët, ndërsa pjesa lindore pa murë mbrojtës ishte e përshtatshme për vrojtim. Oborri i kullave është i rrethuar me mur i punuar nga gurët e gdhendur, me frënxhi, si dhe me një oxhak. Në mes të Kullës është një shtyllë e përbërë nga një gurë i vetëm. Sipas arkitektit Gani Gashi ky është nje rast i rallë i arkitekturës së asaj kohe dhe që ai nuk e ka hasur në kulla të tjera të Kosovës.


SITUACIONI
P 1:200



PËRDHESA
P 1:100



KATI 1
P 1:100
















PRERJA A-A
P 1:100



FASADA LINDORE
P 1:100



FASADA VERIORE
P 1:100













Kompleksi i Kullave të Isë Boletinit përbën atraksion për vizitorët duke ofruar histori, bukuri natyrore, pasuri kulturore, si dhe trashëgimi arkitekturale. Zt. Gazmend Boletini kryen shërbimin e ciceronit dhe i informon vizitorët përgjatë gjithë vizitës në këtë Kompleks. Hapësira ekspozuese brenda Kullës që i ka rezistuar kohës prezenton jetën dhe veprën e Isa Boletinit, megjithëse edhe vetë struktura e Kompleksit flet për rezistencën e kësaj figure dhe të familjes Boletini.
















PAMJE TË MUZEUT

PAMJE TË MUZEUT























Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit ka kufizime në qasshmëri fizike përshkak të fizionomisë së lokacionit dhe ndërtesës dy katëshe e cila është adaptuar në muze nga funksioni i saj origjinal si kullë banimi.

Në oborr janë identifikuar dy disnivelime më të theksuara, dhe të disa të tjera më të vogla. Disnivelimi i parë është në afërsi të Kullës së Burrave (e cila nuk i ka rezistuar kohës), ndërsa disnivelimi i dytë më i theksuar është në hyrje të Kullës së Grave (sot hapësirë ekspozuese).

Kjo ndërtesë shtrihet në dy etazhe; në përdhesë dhe në katin e parë, i cili mund të ngjitet vetëm me shkallë, pjerrtësia e tyre e madhe e pamundëson ngjitjen me mjete ndihmëse.



ANALIZA E QASSHMËRISË

Shkallët e pjerrta



Disnivelimet më të theksuara




Gërmime të patrajtuara




Korridor i ngushtë




ANALIZAT NË KATIN E PARË



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT





ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE




ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

ANALIZAT NË PËRDHESË








Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave
Hapësirë e mbyllur për vizitorë


Kthina e parë e muzeut 0
Kthina direkte pas kthinë së parë 1
Kthina direkte pas kthinë së dytë 2

Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
Hapësira që lidhet me 4 hapësira të tjera

ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE NË PËRHDESË TË K.K.I.B



ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE NË KATIN 1 TË K.K.I.B




PIKAT MË TË VIZITUARA - LËVIZJA E VIZITORËVE NË PËRDHESËN E K.K.I.B













Hapësirat e vizituara më së shumti -
Pikat më atraktive/ tërheqëse për vizitorët -


PIKAT MË TË VIZITUARA - LËVIZJA E VIZITORËVE NË KATIN 1 TË K.K.I.B













Muzeu në Kompleksin e Kullave të Isa Boletinit ka një tipologji qëndrore të zhvillimit të hapësirave ekspozuese. Karakteristikë e këtij muzeu të adaptuar prej një kulle është që përdhesa ka vetëm një kthinë të hapur, megjithëse dikur kishte edhe dy dhoma të ndara. Kjo hapësirë ka dy hyrje paralele, megjithëse hyrja kryesore është ajo që përdoret zakonisht, ndërsa hyrja tjetër zakonisht shfrytëzohet kur është moti më i mirë dhe ka fluks më të madh vizitorësh. Në katin e sipërm nga korridori ka qasje në dy kthina, dhe pas përfundimit të vizitës, vizitorët kthehen jashtë përmes qarkut të njejtë të lëvizjes.



ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE



Kthina e parë e muzeut - 0
Kthina e dytë e muzeut - 1
Kthina e tretë e muzeut - 2

Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
Hapësira që lidhet me 3 hapësira të tjera

02



MUZEU SHTETËROR I KIRSTALEVE DHE MINERALEVE - TREPÇA




MUZEU SHTETËROR I KIRSTALEVE DHE MINERALEVE - TREPÇA

Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-TREPÇA është themeluar në vitin 1964 në Stantërg të Mitrovicës. Bazuar në bukuritë mahnitëse të kristaleve, ka ekzistuar ideja e themelimit të muzeut të kristaleve atje. Në atë kohë kishin filluar grumbullimet e para të mineraleve dhe më pas vendosja e tyre në muze. Fillimisht, numri i nxjerr i kristaleve ishte i vogël, mirëpo me kalimin e kohës ky numër erdhi duke u rritur deri në ditet e sotme. Numri i kristaleve të nxjerra nga vendburimi Trepça është i madh dhe vështirë të dihet numri i saktë i tyre.


Muzeu sot përmban rreth 2 mijë eksponate të ekspozuara nga minerale të ndryshme deri tek mostra të prodhimit të Trepçës gjatë shekullit të kaluar, mjete të punëtorëve etj. 95% e eksponateve janë të minierës së Trepçës, ndërsa ka edhe nga zona të tjera të Kosovës, nga shtetet fqinje, e madje edhe nga vende të tjera të botës si: Portugalia, Maroku, Brazili, Japonia etj.

Gjatë 2011-2012 u realizua ndërtesa e dedikuar për shërbime muzeale të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve - TREPÇA në Stantërg, në afërsi të ish-ndërtesës ku qe vendosur fillimisht muzeu. Ky projekt ishte iniciativë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministrisë së Ekonomisë. Kështu prej vitit 2012 muzeu operon në këtë ndërtesë e cila megjithëse e re, nuk i përmbush të gjitha kërkesat e këtij institucioni.

SITUACIONI
P 1:200




PËRDHESA
P 1:200











PRERJA A-A
P 1:100



FASADA JUGPERËNDIMORE
P 1:100













MSHKMT përbëhet nga një kthinë e vetme ekspozuese. Vizitorët përcillen nga ciceroni që prej hyrjes, duke u njoftuar për Trepçën dhe pasurinë minerare të Kosovës. Në fillim është vendosur maketa e horizonteve nëntokësore të minierës së Trepçës siç shihet në foto 4. Tutje, vitrinat e vendosura në mënyrë linerare implikojnë lëvizjen e vizitorëve. Vitrinat janë të pajisura me ndriçim, brenda përmbajnë minerale nga nëntoka e Mitroicës e më gjerë, të pajisura me karta emërtuese.



















Pjerrina për karroca



Shkallët tek hyrja



Objekti i
ngritur përgjatë
tërë perimetrit



ANALIZA E QASSHMËRISË


Në MSHKM-TREPÇA konfigurimi i terrenit që nga hyrja pa pengesa dhe disnivele e mundëson lehtësisht qasjen deri në objekt.

Vetë objekti meqë është i ngritur në nivel më të lartë nga niveli zero, është bërë i qasshëm me integrimin e rampës për lëvizje të personave me aftësi të kufizuara.

Ndërsa organizimi hapësinor i rafteve dhe vitrinave për ekspozim lë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje brenda objektit, pa pengesa e vështirësi, me përjashtim të disa pjesëve ku komunikimi horizontal ngushtohet.


Ndërtesa ka vetëm një toalet, i cili shfrytëzohet edhe nga stafi edhe nga vizitorët, Duket ditur numrin e lart të vizitorëve që vijnë në grupe të mëdha kjo përbën mungesë në përmbushjen e kërksave të muzeut.

ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT




Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave
Hapësirë e qasshme për vizitorë
Hapësirë e mbyllur për vizitorë

ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE




Kthina e parë e muzeut 0
Kthina direkte pas kthinë së parë 1
Kthina direkte pas kthinë së dytë 2
Kthina direkte pas kthinë së tretë 3
Kthina direkte pas kthinë së katërt 4

ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE




Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
Hapësira që lidhet me 3 hapësira të tjera
Hapësira që lidhet me 4 hapësira të tjera

ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE NË PËRHDESË TË M.T



PIKAT MË TË VIZITUARA - LËVIZJA E VIZITORËVE NË PËRDHESËN E M.T











Hapësira e personelit -
Hapësirë komunikimi për nyje sanitare -
Hapësirat e vizituara më së shumti -
Pikat më atraktive/ tërheqëse për vizitorët -

Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve-Trepça ka një tipologji qëndrore të zhvillimit të hapësirave ekspozuese. Ai ka një strukturë shumë të thjeshtë dhe lehtë të lexueshme edhe nga jashtë edhe në hyrje të ndërtesës. Hapësira ekspozuese e tij është e organizuar si një tërësi e vetme funksionale, cila krijon ndarje dhe stimulon lëvizjen e vizitorëve përmes vitrinave ekspozuese. Në grafikon shihet edhe pjesa e ndërlidhjes së hapësirës ekspozuese me erëmbrojtësin, dhe me hapësirat adminsitrative; të cilat lidhjen linearisht me njëra tjetrën.

ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE



Kthina e parë e muzeut - 0
Kthina e dytë e muzeut - 1
Kthina e tretë e muzeut - 2
Kthina e katërt e muzeut - 3
Kthina e pestë e muzeut - 4



Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera
Hapësira që lidhet me 3 hapësira të tjera
Hapësira që lidhet me 4 hapësira të tjera

03

MUZEU I QYTETIT






MUZEU I QYTETIT

Muzeu u themelua në vitin 1952. Si institucion i kulturës është njëri ndër institucionet më të hershme në Qytetin e Mitovicës. Muzeu u themelua për hulumtimin, grumbullimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale të regjionit të Mitrovicës. Në fillimet e veprimtarisë së tij, Muzeu i Mitrovicës është pasuruar me koleksionin e fosileve. Gjatë kësaj periudhe filluan gërmimet arkeologjike në disa lokalitete në Mitrovicë, gërmime që rezultuan me mijëra gjetje arkeologjike, dhe pjesa tjetër e koleksionit u pasurua nga puna dhe angazhimi i stafit profesional në krye me themeluesin e këtij institucioni drejtorin e parë të muzeut, z.Sylejman Murati. Fillimisht muzeu ishte i vendosur në objektin e vjetër të komunës, kurse në vitin 1960 punën dhe veprimtarine e tij e vazhdoi në objektin e Hamamit të Qytetit. Që nga viti 2009 muzeu e ushtron veprimtarinë e tij në objektin e ish-Shtepisë së Armatës Jugosllave në Mitrovicë.


Për momentin përdhesa e kësaj ndërtese shfrytëzohet nga Muzeu i Qytetit, ndërsa kati shfrytëzohet nga Shkolla Fillore e Mesme e Muzikës “Tefta Tashko”. Ndërtesa e re adekuate për kërkesat e shkollës është duke u ndërtuar kështu që së shpejti ndërtesa do të operoj vetëm si muze. Objekti i ish-Armatës Jugosllave është ndërtuar për nevoja ushtarake në vitin 1959 me stil arkitektonik modernist.

Ky objekt është pjesë e memories kolektive të qytetit, ngase që prej viteve të '70 ky objekt u përdor nga shumë organizata për realizimin e aktivitete të ndryshme kulturore. Pas luftës së fundit në Kosovë, u shfrytëzua nga komanda e KFOR-it Francez e më pas edhe nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Në vitin 2017 për shkak të historisë që prezanton si dhe vlerave arkitektonike që përfaqëson, vjetësisë dhe memories kolektive që komuniteti ka për të, ka hyrë në listën e objekteve të mbrojtura me ligj.

SITUACIONI
P 1:200



PËRDHESA
P 1:200




LEGJENDA

- HAPËSIRA HYRËSE
- KOMUNIKIMI VERTIKAL
- HAPËSIRAT EKSPOZUESE
- HAPËSIRAT E DEDIKUARA PËR STAF & ARKIVIM
- HAËSIRA KOMUNIKUESE
- ATRIUMI
- BIBLIOTEKA
- TOALETET
- HAPËSIRA NËN SHFRYTËZIM TJETËR

ORGANIZIMI FUNKSIONAL I HAPËSIRAVE TË MUZEUT

Muzeu i Mitrovicës operon në ndërtesën e ish-armatës jugosllave. Për momentin në shfrytëzimin e muzeut është pjesa dërrmuese e përdhesës, si dhe oborri i ndërtesës. Hyrja e muzeut shfrytëzohet edhe për hyrja në shkollën e muzikës "Tefta Tashko" e cila gjendet në katin e parë të ndërtesës. Rrjedhimisht holli hyrës është i përbashkët.

Në kohën e realizimit të këtij hulutmimi, muzeu ishte në renovim, andaj në skemën e mëposhtme është paraqitur ndarja funksionale e kthinave ndërsa matja e mobilarit ekspozues nuk është dokumentuar për shkak të vendosjes së tyre jo-përfundimtare. Ndërsa fotot në anën e djathtë prezentojnë gjendjen paraprake të këtyre kthinave ekspozuese.







Fosilet (Burimi: https://lapsi360.com/ - Muzeu i Mitrovicës





Etnologjia (Burimi: https://lapsi360.com/ - Muzeu i Mitrovicës






Arkeologjia (Burimi: https://lapsi360.com/ - Muzeu i Mitrovicës

LEGJENDA

- EREMBROJTËSI
- HOLLI HYRËS
- KOMUNIKIMI VERTIKAL (KATI 1 MOMENTALISHT SHFRYTËZOHET NGA SHKOLLA E MUZIKËS)
- HAPËSIRA EKSPOZUESE 1-FOSILET
- HAPËSIRA EKSPOZUESE 2-ARKEOLOGJIA
- HAPËSIRA EKSPOZUESE 3-ETNOLOGJIA
- HAPËSIRAT E EKSPOZITAVE TË PËRKOHSHME
- EKSPOZITA "ZËRI I PRINDËRVE"
- BIBLIOTEKA
- HAPËSIRA TË DEDIKUARA PËR STAF/ARKIVIM
- ATRIUMI
- KOMUNIKIMI HORIZONTAL (SHFRYTËZOHET EDHE PËR EKSPOZIM)
- TOALETE
- HAPËSIRA NËN RENOVIM
- HAPËSIRA TË PËRDHESËS SË NDËRTESËS QË NUK JANË NËN SHFRYTËZIM TËMUZEUT



PRRERJA A-A

P 1:200

















FASADA KRYESORE

P 1:200

PAMJE TË MUZEUT

Hapësira e brendshme e Muzeut të Qytetit, duke qenë aktualisht në renovim, është dokumentuar përmes këtyre fotografive në gjendje jo të hapur për vizitorë. Rrjedhimisht të gjitha kthinat e dedikuara për arkeologji, etnologji dhe fosile kanë vitrina të dislokuara nga pozicioni i tyre origjinal.






















PAMJE TË MUZEUT

Hapësirat e dedikuara për ekspozita të përkohshme aktualisht përmbajnë ekspozita fotografike. Në dy prej kthinave ekspozita "Gruaja e parë fotografe në Mitrovicë" shpaloset përmes fotografive të shkrepura në vite të ndryshme. Hapësirat e ekspozitave janë të pajisura me ndriqim e poashtu me ulëse, ashtu siç mund të shihet edhe në foto.

Kthina e fundit i është dedikuar ekspozitës së personave të vrarë dhe të pagjetur të komunitetit shqiptar, që prej luftës së vitit 1998-1999 në regjionin e Mitrovicës. Kjo ekspozitë është realizuar nga Shoqata "Zëri i Prindërve".


























Pjerrina për karroca



Dyshemeja në atriumin e brendshëm është shtrembëruar nga rrënjët e drunjëve



ANALIZA E QASSHMËRISË

Muzeu i Qytetit, i gjendur në qendrën e Mitrovicës, ka oborr të rrafshët dhe lehtësisht të qasshëm fizikisht. Ndërtesa megjithëse është e ngritur nga niveli zero, mundëson qasjen për personat me aftësi të kufizuara përmes rampës të vendosur në hyrje. Kjo ndërtesë ka edhe një oborr të brendshëm që shfrytëzohet për aktivitete të hapura, i cili është poashtu i qasshëm përmes një pjerrine që mundëson qasjen nga korridori në atrium.






Shkallët në hyrje të ndërtesës dhe në dalje tek atriumi

Toaletet nuk përmbushin kërkesat për PAK

Kati 1 momentalisht shfrytëzohet nga shkolla e muzikës “Tefta Tashko”, dhe është i qasshëm vetëm përmes shkallëve


Hapësira e ekspozitave të përkohsahme është e qassshme për PAK përmes atriumit

ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT




Vija që tregon ndërlidhjen e kthinave
Hapësirë e qasshme për vizitorë
Hapësirë e mbyllur për vizitorë

ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



Kthina e parë e muzeut 0
Kthina direkte pas kthinë së parë 1
Kthina direkte pas kthinë së dytë 2
Kthina direkte pas kthinë së tretë 3
Kthina direkte pas kthinë së katërt 4

ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



Hapësira që lidhet vetëm me 1 hapësirë tjetër
Hapësira që lidhet me 2 hapësira të tjera
Hapësira që lidhet me 5 hapësira të tjera
Hapësira që lidhet me 9 hapësira të tjera

ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE

Muzeu i Qytetit ka një tipologji komplekse-lineare të zhvillimit të hapësirave ekspozuese. Ai ka një holl hyrës mikëpritës që njëkohësisht shërben si hapësirë ekspozuese për fosile. Nga kjo hapësirë krijohet qasja për në sektorin e arkeologjisë dhe të etnologjisë. Në grafikon shihet edhe pjesa e ndërlidhjes së hollit me korridorin nga i cili zgjerohet pjesa administrative. Tutje janë të vendosura në vijë lineare kthinat e ekspozitave të përkohshme, dhe në fund kthina e ekspozitës të së rënëve në luftën e fundit. Vija e lëvizjes mbrapa deri tek dalja bëhet në hapësirat e njëjta kaluese, përveq tek pjesa e hapësirave të ekspozitave të përkohshme, ku lëvizja mund të bëhet në dy forma; përgjatë korridorit të brendshëm dhe përmes atriumit.

